



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"

GJIROKASTËR

BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 267 Prot.

Gjirokastrë, më 05.03.2021

V E N D I M

NR. 13 , DATË 05.03.2021

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR TRE VENDE TË LIRA PUNE NË POZICIONIN
PUNONJËS SHËRBIMI DHE MIRATIMIN E MARRJES ME KONTRATË ME KOHË
TË PLOTË DHE KOHËZGJATJE TË CAKTUAR**

Në mbështetje të Ligjit Nr.80/2015 datë 22.07.2015, "Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 49, pika f, si dhe bazuar në shkresën e Administratorit të Universitetit me nr., 626 prot., datë 04. 03. 2021, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 05. 03.2021,

V E N D O S I:

1. Të miratojë kriteret për pozicionin e punës "Punonjës Shërbimi" të detajuara si më poshtë:
 - A. **Të interesuarit për pozicionin e mësipërm duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:**
 - Të ketë kryer arsimin e mesëm;
 - Të ketë përvojë pune në grup;
 - Të ketë aftësi të mira komunikuese;
 - Të jetë shtetas shqiptar;
 - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
 - Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
 - Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
 - Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo e një kundërvajtjeje penale me dashje;
 - Të mos jetë marrë ndaj tij masë disiplinore, që nuk është shuar sipas ligjit;

B. Të interesuarit duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kërkesë me shkrim për të aplikuar ;
- Curriculum Vitae (CV);
- Fotokopje e kartës së identitetit;
- Raport mjeko – ligjor;
- Librezë pune, nëse posedon;
- Dëshmi penaliteti ose aplikim për marrjen e saj.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Dr. Merita Isaraj

